

VENDIM
Nr. 572, datë 3.9.2014

**PËR DHËNIEN NË PËRDORIM TË
PËRKOHSHËM, NGA MINISTRIA E
MBROJTJES MINISTRISË SË PUNËVE
TË BRENDSHME, TË OBJEKTIT NR. 42,
ME EMËRTIM “INSTITUTI I
STUDIMEVE DHE PROJEKTIMEVE TË
MBROJTJES”, PËR SHKOLLËN
SHQIPTARE TË ADMINISTRATËS
PUBLIKE, DHE SHFUQIZIMIN E
VENDIMIT NR. 786, DATË 14.11.2012, TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 8, pika 3, 10 e 12, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënien në përdorim të përkohshëm, për një periudhë 40-vjeçare, të objektit nr. 42, me emërtim “Instituti i Studimeve dhe Projektmeve të Mbrojtjes”, nga Ministria e Mbrojtjes Ministrisë së Punëve të Brendshme, për Shkollën Shqiptare të Administratës Publike, sipas formularit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ministrisë së Punëve të Brendshme i ndalohet ta ndryshojë destinacionin e pronës, të përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, ta tjetërsojë ose t’ua japë në përdorim të tretëve. Në rast përfundimi të veprimtarisë së Shkollës Shqiptare të Administratës Publike, para afatit të përcaktuar në këtë vendim, objekti dhe trualli funksional t’i kthehen Ministrisë së Mbrojtjes.

3. Objekti nr. 36, me emërtim “Ish-Kolegji Turk”, dhe trualli funksional, pjesë e pronës nr. 12, me emërtim “Komanda e Doktrinës dhe Stërvitjes”, Tiranë, me sipërfaqe të përgjithshme 7 594 (shtatë mijë e pesëqind e nëntëdhjetë e katër) m², t’i kthehen në përdorim Ministrisë së Mbrojtjes.

4. Vendimi nr. 786, datë 14.11.2012, i Këshillit të Ministrave, “Për dhënien në përdorim të përkohshëm, nga Ministria e Mbrojtjes Ministrisë së Brendshme, të mjediseve të objektit nr. 36, me emërtim “Ish-Kolegji Turk”, dhe të truallit funksional, pjesë e pronës nr. 12, me emërtim “Komanda e Doktrinës dhe Stërvitjes”, Tiranë, me sipërfaqen e përgjithshme 7 594 (shtatë mijë e pesëqind e nëntëdhjetë e katër) m², për Shkollën Shqiptare të Administratës Publike”, shfuqizohet.

5. Ngarkohen ministri i Punëve të Brendshme, ministri i Mbrojtjes dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të

Republikës së Shqipërisë të ndjekin procedurat e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

				Rr.Bulevardi Dëshmoret e Kombit, Tiranë	8882 M2	3160 M2				
38				Objekti zyre ESKU-t	142 M2	142 M2	Per Mbrojtjen	MM Drejtoria Administrates Tiranë	Drejtoria Administrate s dhe Sherbimeve Tiranë	Dhene fond banese
				Prane NPVU-se Tiranë						"
				Zyre ESKU-t	142	142				
39				Objekti Garazhd	82.5 M2	82.5 M2	Per Mbrojtjen	MM Drejtoria Administrates Tiranë	Drejtoria Administrate s dhe Sherbimeve Tiranë	Dhene fond banese
				Prane NPVU-se, Tiranë						
				Garazhd	82.5	82.5				"
40				Zdrukthtari	82 M2	82 M2	Per Mbrojtjen	MM Drejtoria Administrates Tiranë	Drejtoria Administrate s dhe Sherbimeve Tiranë	Dhene fond banese
				Prane NPVU-se, Tiranë						
				Zdrukthtari,	82	82				"
41				Magazine	220 M2	220 M2	Per Mbrojtjen	MM Drejtoria Administrates Tiranë	Drejtoria Administrate s dhe Sherbimeve Tiranë	Dhene fond banese
				Prane NPVU-se, Tiranë						Nje pjese te makazincs NPVU-se
				Makazine	220	220				
42				Instituti Studimeve	1781	662	Për	MM	ISP	

				Projektimeve Mbrojtjes	M2	M2	Mbrojtjen	ISPMbrojtjes Tiranë	Mbrojtjes Tiranë	
				Tiranë	1781	662				
43				Qendra Kulturore Ushtrisë	10060 M2	1402 M2	Për Mbrojtjen	MM Qend.Kultur. Ushtrisë Tiranë	Qendra Kulturore Ushtrisë Tiranë	
				Rr.Bulevardi, " Zhan D Ark ",Tiranë	10060	1402				
44				Linjë Komunikimi kabllore nëntokësore Rep.Ush.Nr.1060	12480 MI	-	Për Mbrojtjen	MM Rep.Ush1060 Tiranë	Rep.Ush. Nr.1060 Tiranë	Dy drejtime
				Ministria Mbrojtjes - Repart i 1070, Tiranë	12480 MI	-				
45				Linjë Komunikimi kabllore nëntokësore Rep.Ush.Nr.1060	3300 MI	-	Për Mbrojtjen	MM Rep.Ush1060 Tiranë	Rep.Ush. Nr.1060 Tiranë	
				Ministria Mbrojtjes - Komanda Doktrinave Tiranë	3300 MI	-				
46				Linjë Komunikimi kabllore nëntokësore Rep.Ush.Nr.1060	3250 MI	-	Për Mbrojtjen	MM Rep.Ush1060 Tiranë	Rep.Ush. Nr.1060 Tiranë	
				Ministria Mbrojtjes - Pallati Brigatave,Tiranë	3250 MI	-				
47				Linjë Komunikimi kabllore nëntokësore	3320 MI	-	Për Mbrojtjen	MM Rep.Ush1060 Tiranë	Rep.Ush. Nr.1060 Tiranë	